



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 157/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.04.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, Nr. REF-86440-02-09-2021 me objekt “Shërbimi i Printimit të Njoftim Detyrimeve për vitin 2021”, me fond limit 6.666.264 leke pa TVSH, zhvilluar në datën 16.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV).

Ankimues: “Inpress” SHPK
Rruga “Siri Kodra, ish –blloku i magazinave, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV)
Rruga e Kavajës, ish Uzina Mekanike, Hyrja 203, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.02.2021, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “prokurimit “Kërkesë për Propozime”, Nr. REF-86440-02-09-2021 me objekt “Shërbimi i Printimit të Njoftim Detyrimeve për vitin 2021”, me fond limit 6.666.264 leke pa TVSH, zhvilluar në datën 16.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV).

II.2. Në datën 16.03.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në

datë 19.03.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Adel Co” SHPK.	3.165.521 lekë	skualifikuar
2. “Inpress” SHPK	5.695.680 lekë	skualifikuar
3. “Albdesign PSP” SHPK	6.597.964 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 19.03.2021, operatori ekonomik “Inpress” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen si më poshtë: *Në lidhje me punime të ngjashme, subjekti referuar dokumentacionit të paraqitur, ka realizuar punime zarfimi të cilat në total kapin vlerën prej 1.241.960 lekë pa TVSH (2 fatura me nga 500.000 lekë dhe 1 fature me vlerë 1966.66 €). Lidhur me këtë, përveç faktit që nuk arrin vlerën 40% të fondit limit (procesi i zarfimit) argumentojmë se edhe procesi i realizimit të këtyre kontratave nuk na bind të dalim në një konkluzion që kjo kompani mund të realizojë me sukses objektin e prokurimit.*

Në lidhje me certifikatat ISO, në asnjë prej certifikatave të paraqitura nga subjekti nuk përfshihen fusha të njëjta me objektin e prokurimit sikurse është kërkuar në DST: “ Certifikatat duhet te jene ne te njejten fushe me kategorine dhe specifikën e shërbimeve qe prokurohen”, konkretisht nuk përfshihen “ Printime dixhitale, Zarfime apo printime me të dhëna variable.

Në lidhje me mostrat e paraqitura nga subjekti Inpress shpk konkludojmë se ato nuk janë konform kërkesave në specifikimet teknike pasi zarfet e paraqitur janë të tipit me shirit ngjitës manual dhe jo të llojit për zarfim automatik.

II.4. Në datën 23.03.2021 operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...] Në vijim të procedurës së prokurimit të Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore me objekt Shërbimi i Printimit të Njoftim Detyrimeve për vitin 2021”, me fond limit 6.666.264 leke pa TVSH, publikuar më 10.02.2021 e cila u zhvillua më 16.03.2021.

Vlerësimi i ofertave për procedurën e lartpërmendur u zhvillua nga autoriteti kontraktor në datën 19.03.2021. Në këtë procedurë prokurimi paraqitën ofertat operatorë ekonomikë të poshtëshënuar, të cilët autoriteti kontraktor i klasifikoi në këtë mënyrë:

“Adel Co” SHPK	3.165.521 lekë	skualifikuar
“Inpress” SHPK	5.695.680 lekë	skualifikuar
“Albdesign PSP” SHPK	6.597.964 lekë	kualifikuar

Në njoftimin e marrë nëpërmjet sistemit elektronik të APP-së Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë AK-së u informuam se:

Në lidhje me punime të ngjashme, subjekti referuar dokumentacionit të paraqitur, ka realizuar punime zarfimi të cilat në total kapin vlerën prej 1.241.960 lekë pa TVSH (2 fatura me nga 500.000 lekë dhe 1 fature me vlerë 1966.66 €). Lidhur me këtë, përveç faktit që nuk arrin vlerën 40% të fondit limit (procesi i zarfimit) argumentojmë se edhe procesi i realizimit të këtyre kontratave nuk na bind të dalim në një konkluzion që kjo kompani mund të realizojë me sukses objektin e prokurimit.

Në lidhje me certifikatat ISO, në asnjë prej certifikatave të paraqitura nga subjekti nuk përfshihen fusha të njëjta me objektin e prokurimit sikurse është kërkuar në DST: “ Certifikatat duhet të jene ne te njejten fushe me kategorine dhe specifiken e sherbimeve qe prokurohen”, konkretisht nuk përfshihen “ Printime dixhitale, Zarfime apo printime me të dhëna variable.

Në lidhje me mostrat e paraqitura nga subjekti Inpress ShPK konkludojmë se ato nuk janë konform kërkesave në specifikimet teknike pasi zarfet e paraqitur janë të tipit me shirit ngjitës manual dhe jo të llojit për zarfim automatik.

Duke qene se ky vendim i KVO, te Autoritetit Kontraktor eshte teresisht i gabuar dhe bie ne kundershkrim me dispozitat ligjore dhe nenligjore te fushes, ne fuqi ...

...mbeshtetur ne nenin 63 pika 2, te ligjit nr 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.914, date 29.12.2014 "Per rregullat e prokurimit publik", i ndlyshuar', ne vijim te procesit te rivleresimit te ofertave per tenderin, dhe brenda afatit 7 ditor nga dita e neserme e njoftimit nga ana e Autoritetit Kontraktor të këtij vendimi, ju kërkojmë ndryshimin e këtij vendimi të KVO-së të AK duke parashtruar kundershkrite tona, si dhe arsyet ligjore ku bazohen keto kundershkrite, si vijon:

Per sa i perket vendimit te KVO te AK, per Skualifikimin e Operatorit Ekonomik "Inpress" ShPK., ju paraqesim kundershkrite tona si vijon:

1. Per sa i perket arsyes së parë së skuialifikimit OE Inpress ShPK.:

"Në lidhje me punime të ngjashme, subjekti referuar dokumentacionit të paraqitur, ka realizuar punime zarfimi të cilat në total kapin vlerën prej 1.241.960 lekë pa TVSh (2 fatura me nga 500.000 leke dhe 1 fature me vlere 1966.66 €). Lidhur me kete, nuk arrin vleren 40% te fondit limit (procesi i zarfimit);

Ju paraqesim kundështitë tona si vijon:

Ne Dokumentet Standarde te Tenderit per proceduren e prokurimit te lartpermendur, Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV) - Bashkia Tirane eshte percaktuar se:

2.3Për kapacitetin teknik:

a. Përvojë e suksesshme në kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme në një vlerë të paktën prej 40% të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit, deri në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

•Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore Operatori Ekonomik duhet ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.

•Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik duhet ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të nënshkruara nga të dyja palët ku të shprehen qartë, datat shumë dhe shërbimet e realizuara.

Në shtojcën 8 Specifikimet Teknike për Shërbimin e Printimit të Njoftim Detyrimeve për vitin 2021

Nr.	Artikulli	Karakteristika teknike	Njësia Matjes	Sasia

1	Prodhim fletë njoftim detyrimi Zarfa dhe zarfim	Zarf DL me dritare për zarfim automatik me logo bardhë e zi + mesatarisht 2.2 fletë të printuara me të dhëna variable para mbrapa, nga njëri krah me ngjyra+zarfim. Fleteve i duhet vendosur nga një barcode unik në mënyrë që sistemi i zarfimit të bëjë ndarjen e fletëve në çdo zarf. Çdo zarf do të ketë sasi të ndryshme fletësh. Sistemi i prodhimit të OE duhet të jetë në gjendje ta bëjë vetë ndarjen e fletëve për çdo zarf.	Set	93.988
2	Prodhim fletë njoftim detyrimi	Printimi nga 2 krahet me të dhëna variabël bardhë e zi (mesatarisht 2.2 fletë * 93.988 nr. subjekte * 2 kopje njoftim detyrimi)	Fletë	413,548

Në shtojcën 8 “Specifikimet Teknike “ përcaktohet gjithashtu:

1. PËRCAKTIMI I FORMATIT TË FLETË DETYRIMEVE

Formati i fletë detyrimeve të kërkuara nga Institucioni jonë për njoftimin e subjekteve në lidhje me detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2021 duhet të jetë:

- Formati A4, printimi në të dy anët
- Përmasat e letrës të jenë 210x297 mm
- Lloji letrës 90 gram/m²
- Ngjyra e letrës, e bardhë absolute në mënyrë që të ketë kontrast në printim
- Të jetë me sipërfaqe të lëmuar
- Të plotësojë standardet që letra të ruhet për një periudhë kohe jo më pak se 10 vjet në arkiv.
- Dukshmëria: > 94%
- Shkëlqimi: 101-104%
- Të mos jetë e ricikluar
- Numri total i fletë për tu printuar do të jetë mesatarisht 620.321.

Në përputhje të plotë me kërkesat e DST operatori ekonomik “Inpress” ShPK për të provuar përvojën e mëparshme për kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme ka paraqitur këto dokumente:

Fature tatimore shitje, tek bleresi Infosoft Softeare Developement ShPK "Printime dhe zarfim (insertim) automatik" me vlere 500.000 (pese qind mije) leke pa TVSH;

Fature tatimore shitje, tek bleresi Printing Opportunity shpk "Printime dhe zarfim (insertim) automatik" me vlere 500.000 (pese qind mije) leke pa TVSH;

Fature tatimore shitje, tek bleresi Studio Tartari ShPK "Printime dhe zarfim (insertim) automatik" me vlere 1.967 (nje mije e nëntëqind e gjashtedhjetë e shtatë) Euro pa TVSH (kursi i kembimit: 1 E =123.3 lekë);

Fature tatimore shitje, tek bleresi Studio Tartari ShPK "Printime te ndryshme" me vlere 12.500 (dymbëdhjetë mije e pesëqind) Euro pa TVSH (kursi i kembimit: 1 E = 123. 03 Leke);

Fature tatimore shitje, tek bleresi Ujesjelles Kanalizime Tirane SHA " Printim Fatura Debitorë" me vlere 263.573 (dyqind e gjashtedhjetë e tre mije e pesëqind e shtatëdhjetë e tre) leke pa TVSH;

Fature tatimore shitje, tek bleresi "Interlogistic" ShPK., te produkteve me pershkrim : "Printim të dhënash version zarfa selfmailer" me vlerë 465.418 (katerqind e gjashtedhjetë e pesë mije e katerqind e tetëmbëdhjetë) leke pa TVSH.

Fature tatimore shitje, tek bleresi "Marketing & Distribution" ShPK te produktit produkteve me pershkrim "Printim të dhënash version zarfa selfmailer", me vlere 3.000.000 (tre milion) leke pa TVSH.

Fature tatimore shitje, tek bleresi "Marketing & Distribution" ShPK te produktit produkteve me pershkrim "Printim të dhënash version zarfa selfmailer", me vlere 2.501.000 (dy milion e pese qind e nje mije) leke pa TVSH.

Fature tatimore shitje, tek bleresi "Office Center" ShPK te produktit produkteve me pershkrim : "Printim të dhënash version zarfa selfmailer", me vlere 2.000.000 (dy milion) leke pa TVSH. Kontrate furnizimi, fature tatimore, liste produktesh, vertetim realizimi, tek Autoriteti Kontraktor "Agjencia Shteterore e Kadastres" per produktet me pershkrim "Printim Certifikata Pronesie" me vlere 349.000 (treqind e dyzete e nente mije) leke pa TVSH.

Fatura tatimore shitjesh, tek bleses shkola te ndryshme private per produktet me pershkrir: Printim "Dëftesa "; Printim "Diploma"; "Regjistra & Amza"; Printim "Certifikata "; me vlere 1.522.830 (nje million e pese qind e njezet e dy mije e teteqind e tridhjetë) leke pa TVSH.

Kontrate furnizimi, fature tatimore, liste produktesh, vertetirn realizimi, Autoriteti Kontraktor "Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise" te produkteve me pershkrim: Printim "Deftesa"; Printim "Diploma"; "Regjistra & Amza ": Printim "Certifikata "; me vlere 4.849.599 (kater million e tete qind e dyzete e nente mije e pese qind e nentedhjetë e nente) leke pa TVSH. Kontrate furnizimi, fature tatimore, liste produktesh, vertetim realizimi, Autoriteti Kontraktor "Agjencia Kombetare e Turizmit" te produkteve me pershkrim: "Printime+Shtypshkrime" me vlere 11.176. 700 (njëmbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mije e shtatëqind) leke pa TVSH.

Faturë tatimore tek blesësi "Interlogistic" ShPK., teprodukteve me përshkrim "Printime + Shtypshkrime", me vlere 57,881,332 (pesëdhjetë e shtatë milion e teteqind e tetëdhjetë e nje mije e treqind e tridhjetë e dy) leke pa TVSH.

Kontratë furnizimi, faturë tatimore listë produktesh, vërtetim realizimi, Autoriteti Kontraktor "Posta Shqiptare" shat ë produkteve me përshkrim: " Printime+Shtypshkrime" me vlerë 25.470.700 (njëzet e pesë million e katërqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH.

Kontratë furnizimi, faturë tatimore, listë produktesh, vërtetim realizimi, Autoriteti Kontraktor "Bashkia Elbasan" të produkteve me përshkrim: " Printime+Shtypshkrime" me vlerë 2.446.000 (dy million e katërqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.

Faturë tatimore shitje tek blerësi “Interlogistic” ShPK të produkteve me përshkrim: “Printime +Shtypshkrime” me vlerë 14.748.510 (katërbëdhjetë million e shtatëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

Faturë tatimore shitjeje tek blerësi “Interlogistic” ShPK. të produkteve me përshkrim: “Printime+Shtypshkrime” me vlerë 11.323.900 (njëmbëdhjetë million e treqind e njëzet e tre mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH. Bazuar në dokumentacionin ligjor/teknik të mësipërm të depozituar rregullisht nga operatori ekonomik “Inpress” shpk në këtë procedurë prokurimi, vërtetohet qartësisht se oe “Inpress” sh.p.k. jo vetëm që e përmbush plotësisht kriterin e kryerjes së shërbimeve me natyrë të ngjashme, por e tejkalon atë disa herë, si përsa I përket cilësisë, ashtu edhe sasisë dhe volumit të shërbimeve me natyrë të ngjashme.

Në dokumentat standarte të tenderit fondi limit për procedurën e prokurimit në fjalë është 6.666.264 lekë pa TVSH. Sipas parashikimevetë DST për të provuar kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme të mëparshme oe duhet të paraqesin dokumenta që provojnë se përvoja e ngjashme kap vlerën 40% të fondit limit.

Vlera 40% e fondit limit të procedurës së prokurimit të lartëpërmendur është 2.666.505 (dy million e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e pesë)lekë pa TVSH.

Vlera 40% e fondit limit të procedurës të prokurimit të lartë përmendur për zërin e parë “Prodhim fletë njoftimi detyrimi –zarfa-zarfim” është përafërsisht 902.285 (nëntëqind e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Vlera 40% e fondit limit të procedurës së prokurimit të lartë përmendur për zërin e dytë “ Prodhim fletë njoftim detyrimi” është përafërsisht 1.764.196 (një million e shtatëqind e gjashtëdhjetë katër mijë e njëqind e nëndëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Më poshtë gjeni një tabelë ilustruese të vlerës së fondit limit sipas zërave+vlerës 40% shërbim/punë e ngjashme/sipas zërave të kërkuar në dst:

Tabela 1								
Vlera e fondit sipas zërave+vlera 40%shërbim/punë e ngjashme/sipas zërave të kërkuar në dst								
Nr	Përshkrimi i mallrave	Njësi	sasia	Çmimi/Njësi	Vlera Fondit Limit	Përqindja e vlerës/sipas zërave/në raport me fondin limit	Vlera 40%e fondit limit/ e kërkuar në dst/punë e ngjashme sipas zërave	
1	Prodhim fletë njoftim detyrimi -zarfa dhe zarfim	set	9398	24	2.2557	< 35%	902.285	
2	Prodhim fletë njoftim detyrimi	fletë	4135	10.665	441048	> 65%	1764196	
Çmimi neto pa tvsh					666620	total 40%e fondit limit	2666481	

tvsh 20%				133324 0		
Çmimi total (me tvsh)				799944 2		

Ndërkohë operatori ekonomik "Inpress" shpk ka paraqitur dokuemnta që provojnë përvojën e ngjashme si më poshtë:

Vlera totale punë të ngjashme paraqitur nga Inpress shpk sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dst në procedurën e prokurimit të lartë përmendur është 140.778 lekë pa tvsh

Vlera totale punë e ngjashme/identike me zërin 1 të shërbimeve/produkteve të kërkuara "Printime dhe zarfim (insertim) automatic paraqitur nga Inpress shpk sipas kërkesës dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dst e procedurës së lartë përmendur është 1.241.960 lekë pa tvsh faturat 1-3 të dorëzuara nga Inpress shpk.

Vlerë kjo e pranuar qartësisht edhe kvo e ak-së në vlerësimin e ofertave.

Vlera totale pune e ngjashme/identike me zërin 2 të shërbimeve/produkteve të kërkuara "Printime fletë A4" paraqitur nga Inpress shpk, sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dst e procedurës së prokurimit të lartë përmendur është 9.767.491 lekë pa tvsh faturat 4-9 të dorëzuar nga Inpress shpk.

Vlera totale e punëve të tjera të ngjashme/të përafërta me zërin 1 dhe 2 të shërbimeve të produkteve të kërkuara "Printime dhe zarfim (insertim) automatic dhe printime në fletë A4 paraqitur nga Inpress shpk sipas kërkesës dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dst e procedurës së prokurimit të lartë përmendur është 129.768.549 lekë pa tvsh faturat-10-18 të dorëzuara nga Inpress shpk.

Tabela 2					
Vlera e shërbimeve/punëve të ngjashme/sipas zërave të dorëzuara nga Inpress shpk					
Nr	Përshkrimi i mallrave sipas DST	Përshkrimi i shërbimeve sipas specifikimeve teknike në dst	Vlera punë e ngjashme/ e kërkuar në dst/sipas zërave	Vlera Punë e ngjashme/identike/dorëzuar nga Inpress shpk	
1	Prodhim fletë njoftim detyrimi - zarfa dhe zarfim	Printime dhe zarfim (insertim) automatik	902285	1.241.960	
2	Prodhim fletë njoftim detyrimi	Printime fletë A4	1.764.196	9.767.491	
3	Shërbime të ngjashme të	Punë të			129.768.549

<i>përafërta dorëzuar nga Inpress ShPK</i>			
<i>Çmimi neto (pa TVSH)</i>		<i>2.666.48</i>	<i>140.778.000</i>
<i>TVSh 20%</i>			<i>28.155.600</i>
<i>Çmimi total (me TVSh)</i>			<i>168.933.600</i>

Siç mund të shihet lehtësisht vlera e shërbimeve/punëve të ngjashme që është paraqitur nga operatori ekonomik Inpress ShPK është disa herë më e madhe se ajo që kërkohet si për sa i përket secilit zë të shërbimeve/produkteve të kërkuara ashtu edhe për sa i përket totalit të tyre.

Pra siç e theksuam edhe më sipër OE Inpress ShPK jo vetëm që e plotëson kriterin e kryerjes së shërbimeve me natyrë të ngjashme të mëparshme por e tejkalon shumë herë atë. Gjithashtu siç mund të vihet re lehtësisht nga të gjithë dokumentet e renditur më lart OE Inpress ShPK vërteton se ka të gjitha kapacitetet dhe eksperiencat e mëparshme të ngjashme për të kryer shërbime punë shumë më komplekse se ajo që kërkohet në DST.

Pra pretendimi i KVO –së pranë AK-së është tërësisht i pasaktë i pabazuar në fakte konkrete dhe reale si dhe i paligshëm kështu që për këtë arsye duhet të ndryshohet. Për sa i përket kësaj çështje (punëve apo kontratave të ngjashme) KPP ka mbajtur një qëndrim konstant duke parashtruar në mënyrë të qartë: Referojmë[...]

Referojmë vendim KPP 304/2016[...]

Vendime të tilla të ngjashme të KPP janë të shumta për sa i përket kësaj çështjeje

Duke u rikthyer në rastin tonë konkret do të donim të parashtronim se:

Punët/Shërbimet/furnizimet e ngjashme të paraqitura/depozitura nga operatori ekonomik “Inpress” ShPK për këtë procedurë tenderuese janë disa herë më të mëdha dhe më të rëndësishme si nga ana sasiore ashtu edhe nga ana cilësore dhe profesionale e realizimit të tyre, në proporcion me cilësinë dhe sasinë e mallrave objekt prokurimi. Fakt ky që vërteton qartësisht se oe Inpress ShPK gëzon të gjitha kapacitetet në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Thënë ndryshe bazuar në dokumentacionin e paraqitur/depozituar pranë AK vërteton se zotëron reputacionin besueshmërinë dhe përvojën e duhur për të zbatuar me sukses kontratën objekt prokurimi.

Për sa i përket arsyes së dytë të skualifikimit të OE Inpress ShPK

Argumentojmë se edhe procesi i realizimit të këtyre kontratave nuk na bind të dalim në një konkluzion që kjo kompani mund të realizojë me sukses objektin e prokurimit. Do të donim të theksonim se kjo arsye e pretenduar nga KVO e AK për skualifikimin e OE Inpress ShPK është tërësisht e gabuar dhe e kundërligjshme dhe mbi të gjitha është një arsye subjektive e pa mbështetur në asnjë situatë faktike provë apo dokumentacion ligjor.

Në zbatim dhe përputhje me LPP dhe RrPP-të AK do të duhet të shqyrtojnë ofertat ekonomike dhe dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur nga OE pjesëmarrës në mënyrë objektive dhe bazuar thellësisht në dokumentet e dorëzuar nga këto OE.

Kurresesi AK nuk mund të gjykojë në mënyrë subjektive dhe të skualifikojë një OE pjesëmarrës, pasi në gjykimin subjektiv të autoritetit kontraktor ky OE pjesëmarrës nuk është i aftë të realizojë me sukses kontratën. Edhe nëse OE pjesëmarrës, mund të kemi rezervat dhe

hamendesimet tona subjektive, mbi arsyet qe diktojne AK_Drejtoria e Pergjithshme e Tarifave dhe Taksave Vendore Tirane, te kualifikoje dhe shpalle fitues (duke skualifikuar te gjithë operoret e tjere ekonomike pjesemarres) prej disa vitesh rresht vetem OE Albdesign PSP ShPK., pavaresisht faktit se ky OE vijon te paraqese rregullisht nje oferte ekonomike qe varion nga -1 % deri ne -2% me te vogel se vlera e fondit limit, dhe eshte renditur gjithmone i fundit ne garen e zhvilluar prane ketij AK. .. ?! Por rezervat dhe hamendesimet subjektive tona mbi keto arsye, per aq kohe sa nuk jane te mbeshetura ne prova dhe ne fakte, nuk mund te konsiderohen kurresesi te mjaftueshme per te etiketuar dhe paragjykuar punen dhe veprimtarine e AK Drejtoria e Pergjithshme e Tarifave dhe Taksave Vendore Tirane. E njejta gje do te duhet te vlejë edhe per KVO e AK, per sa i perket vleresimit subjektiv te ofertes se paraqitur nga OE Inpress ShPK. OE "Inpress" ShPK., bazuar ne dokumentacion e paraqitur/depozituar prane AK, verteton qartesisht se zoteron reputacionin, besueshmerine dhe pervojen e duhur, per te zbatuar me sukses kontraten objekt prokurimi. 3. Per sa i perket arsyes se trete te Skualifikimit te OE Inpress ShPK.: Në lidhje me certifikatat ISO, në asnjë prej certifikatave të paraqitura nga subjekti nuk përfshihen fusha të njejta me objektin e prokurimit sikurse është kërkuar në DST: “ Certifikatat duhet të jenë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen”, konkretisht nuk përfshihen “ Printime dixhitale, Zarfime apo printime me të dhëna variable. Edhe kjo arsye e pretenduar nga KVO e AK, është teresisht e padrejte dhe e kundërligjshme dhe jo në përputhje me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, për arsyet e mëposhtme:

- a) Në të gjitha Certifikatat ISO të paraqitura nga OE Inpress ShPK. OBJEKTI i aktivitetit i veprimtarisë së Certifikuar është: "Kryerje aktiviteti shtypshkrimesh, printimesh, etj. Prodhime shtypshkrimesh printimesh, etj. Shkollorë, tregtare, me elemente të sigurisë dhe publicitare etj.
- b) Gjithashtu, të gjitha Certifikatat ISO të paraqitura nga OE Inpress ShPK përcaktohet qartesisht se OE është Certifikuar për ushtrimin/ kryerjen e aktivitetit/veprimtarisë tregtare dhe ekonomike për Sektorët EA 08 dhe EA 09,... të cilat korrespondojnë respektivisht:
EA 08- Prodhimi i shtypshkrimeve dhe printimeve, etj. ;
EA 09 - Veprimtari tregtare / ekonomike të lidhura me aktivitetin e shtypshkrimeve, printimeve, etj.

Per sa me siper, arsyet e pretenduar nga KVO e AK, per skualifikimin e OE Inpress ShPK eshte teresisht e pabazuar ne fakte konkrete dhe e kundërligjshme, pasi objekti i veprimtarisë së Certifikuar në ISO-t e dorëzuara nga OE Inpress ShPK, është gjithëpërfshirës për sa i përket fushes / sektoreve të Veprimtarive të Certifikuar EA 08 dhe EA

09, të cilat përfshijnë edhe fushën e "Printime dixhitale, Zarfime apo printime me të dhëna variabël"

Per sa me siper, KSHA e AK, do të duhet të ndryshojë vendimin e KVO të AK për sa i përket kesaj pike.

4. Për sa i përket arsyes së katërt të Skualifikimit të OE Inpress ShPK:

Në lidhje me mostrat e paraqitura nga subjekti Inpress ShPK konkludojmë se ato nuk janë konform kërkesave në specifikimet teknike pasi zarfet e paraqitur janë të tipit me shirit ngjithës manual dhe jo të llojit për zarfim automatik."

Edhe kjo arsye e pretenduar nga KVO e AK, per skualifikimin e OE Inpress ShPK, eshte teresisht e pabazuar ne fakte dhe ne kundershkrim me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, per arsyet e meposhtme:

Ne piken 2.3/c) "Kapacitetet Teknike", te shtojces 7, te DST percaktohet:

"Mostrat - Ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave. OE duhet të paraqese minimalisht 10 modele të njoftim detyrimi me zarf me të dhëna variabël ku informacioni variabël mund të jetë vetëm për ilustrim, ndërkohë që karakteristikat teknike duhet të jenë të njëjta me ato të kërkuara në specifikime dhe në modelin e parqitur. "

Ne perputhje te plote me kerkesat dhe specifikimet teknike te DST, ditën dhe oren e hapjes se ofertave, OE Inpress ShPK., ka dorezuar me procesverbal te rregullt 20 (njezet) mostra/modele te ngjashme "Njoftim Detyrimi" me të dhëna variabël të insertuara automatikisht në 2 grupe/modele të ndryshme zarfash-10 (dhjetë) mostra/modele për secilin grup/model; të gjitha zarfet e dorëzuara janë të vulosura me vulën e shoqërisë Inpress ShPK.

Eshte e vertete qe njeri grup/model zarfi prej 10 (dhjete) mostra modele te paraqitur nga OE Inpress ShPK jane te tipit me shirit ngjites manual dhe jo te llojit per zarfim automatik, sipas pretendimeve te KVO te AK, ...

... por nga ana tjeter eshte mese e vertete qe grupi tjeter prej 10(dhjetë) mostrave/ modele zarfash, te paraqitura nga OE Inpress ShPK., jane te tipit/te llojit per zarfim automatik, sipas te gjitha specifikimeve te percaktuara ne DST e procedures prokuruese, objekt i kesaj ankese.

Verifikimi i kesaj pike eshte mëse i lehte, pasi kemi te bejme me nje suate faktike, ku zarfat e dorezuara rregullisht nga OE Inpress ShPK. gjenden prane AK, ... dhe rrjedhimisht KSHA e AK, e ka te lehte te dale ne nje konkluzion te drejte,

Per te gjitha sa u parashtruam më sipër kerkojme nga KSHA e AK, Drejtoria e Pergjithshme e Tarifave dhe Taksave Vendore Tirane:

a) Ndryshimin e vendimit te KVO-se, duke kualifikuar keshtu OE "Inpress" ShPK.;

b) Shpalljen fitues se procedures se prokurimit publik, objekt i kësaj ankese, OE "Inpress" ShPK. [...]

II.6. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë KPP, nga autoriteti kontraktor, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues konstatohet se autoriteti kontraktor me anë të shkresën nr.6424/43 prot, datë 26.03.2021, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik "Inpress" SHPK duke e pranuar pjesërisht atë dhe konkretisht (citojmë):

[.] Sa më sipër lidhur me kundërshtitë tuaja KSHA-ja vlerëson si më poshtë: Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga OE përsa i përket kriterit për kualifikim për kontrata të ngjashme, faturat e paraqitura nga ana e operatorit për shërbimet e kryera nuk përmbajnë karakteristikat dhe specifikimet e kërkuara në kriteret për kualifikim nga na e AK-së në DST, për mënyrën e realizimit të këtij shërbimi, në versionin printim/zarfim (insertim).

Pavaresisht se është për tu vlerësuar fakti që ju si shoqëri shpreheni se keni kapacitet dhe eksperiencat për të kryer punë shërbime më komplekse dhe disa herë më të mëdha e rëndësishme se ajo që kërkojmë ne si AK, theksojmë se nuk keni dëshmuar mbi eksperiencat sipas përcaktimeve ligjore për sa i përket objektit specifik të kërkuar dhe përcaktuar qartësisht në DST. Sqarojmë se

procesi i printimit/zarfimit të Njoftim Detyrimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore nuk kanë të njëjtat specifika me printim të dhënash dhe zarfim në versionin selfmailer, pasi në versionin selfmailer printimi i të dhënave bëhet në një fletë në mënyrë që zarfimi të bëhet po në të njëjtën fletë me ngjitje, ndërsa procesi i zarfimit i përcaktuar në specifikimet teknike në DST është i ndarë nga procesi i printimit. Theksojmë se këto dy procese duhet të jenë detyrimit të ndara duke marrë në konsideratë edhe faktin që Njoftim Detyrimet e nxjerra në shumicën e rasteve përbën nga një numër i konsiderueshëm fletësh dhe nuk mund të realizohen në mënyrën selfmailer sipas përcaktimeve në DST.

Gjithashtu makineritë që kryejnë zarfimin në formën selfmailer nuk janë të njëjta me makineritë që kryejnë procesin e zarfimit të shkëputur (me zarf) pasi makineria e parë është makineri palosje me ngjitje, ndërsa e dyta bën hapjen automatike të fletëve në zarf.

Për të vazhduar më tej mbi pretendimet e ngritura nga ana juaj të cilat bazohen tek Vendimi KPP 304/2016 vendim i cili është paraqitur për të mbështetur kundërshtitë tuaja, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj vendimin KPP 197/2020 lidhur me shqyrtimin e ankesës së bërë nga ana juaj për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi i Printimit të Njoftim detyrimeve për vitin 2020” Referojmë[...].

Në përfundim të argumenteve të sipërcituar lidhur me kundërshtitë e paraqitura, KSHA-ja gjykon se pretendimet e ngritura nuk qëndrojnë.

Në vijim lidhur me pikën e dytë të skualifikimit ndër të tjera shpreheni se:

Referojmë pretendimin[...].

KSHA-ja pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit shprehet se KVO në skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues është bazuar tërësisht në vlerësimin e dokumentacionit të depozituar dhe raportin e tij mes kritereve për kualifikim të OE pra sesa janë përmbushur gjithë kriteret e kërkuara në DST nga AK.

Thënë kjo arsye e skualifikimit të operatorit ekonomik të gjykuara nga KVO-ja nuk janë subjektive siç pretendoni ju por të mbështetura në dokumentacionin e depozituar.

Subjektive dhe paragjyqese rezultojnë të jenë hamendësimet tuaja mbi zvillimin e procedurës së prokurimit të kryer nga AK-ja gjatë viteve të ndryshme çka në gjykimin tonë janë të tejkaluara dhe pa vend. Gjithsesi, ndodhur para këtyre rezervave duke marrë të mirëqenë fatin që nga ana juaj janë shprehur pa u thelluar në seriozitetin e akuzave të ngritura ju bëjmë me dije se kjo procedurë prokurimi ka kaluar çdo vit me vendim të KPP-së i cili është autoriteti më i lartë në RSH që mund të vlerësojë hetojë dhe gjykojë procedurat e prokurimit.

Për sa i përket pikës së tretë të skualifikimit jeni shprehur:

Referojmë pretendimin e OE-së[...].

KSHA-ja pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të depozituar mbi ISO-t vlerëson se në fushën e veprimtarisë së ISO-ve të paraqitura nuk është përfshirë “zarfimi”, kështu pretendimi i ngritur nga ana juaj nuk qëndron.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës suaj KSHA-ja gjykon si të drejtë pikën katër të ankimit dhe vendosë ta pranojë atë. [...]

II.7. Në datën 31.03.2021 operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 6424/47 prot., datë 06.04.2021, protokolluar me tonën në datën 07.04.2021, me objekt “Dërgim informacioni në zbatim të vendimit nr. 510/1prot., datë 02.04.2021 të KPP-së për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi i printimit të njoftim Detyrimeve për vitin 2021”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Në lidhje me punime të ngjashme, subjekti referuar dokumentacionit të paraqitur, ka realizuar punime zarfimi të cilat në total kapin vlerën prej 1.241.960 lekë pa TVSH (2 fatura me nga 500.000 lekë dhë 1 fature me vlerë 1966.66 €). Lidhur me këtë, përveç faktit që nuk arrin vlerën 40% të fondit limit (procesi i zarfimit) argumentojme se edhe procesi i realizimit të këtyre kontratave nuk na bind të dalim në një konkluzion që kjo kompani mund të realizojë me sukses objektin e prokurimit.” , Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, gërma “a” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar:

a. Përvojë e suksesshme në kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme në një vlerë të paktën prej 40% të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit, deri në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

